



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 98, datë 30.09.2020

PËR
MIRATIMIN E NJË SHTESE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 468,
DATË 23.12.2017 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË
QYTETIN E DURRËSIT”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit funeral”, Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, VKB nr. 468, datë 23.12.2017 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, i ndryshuar, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e Punëve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 468, datë 23.12.2017 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

Në faqen 35 të Vendimit nr. 468, datë 23.12.2017 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit” të ndryshuar, pas tabelës nr. 40, shtohet tabela nr. 41 me emërtimin dhe vlerat si më poshtë vijon:

Tabela nr. 41 : Tarifa e Shërbimit Funeral për qytetin e Durrësit

Nr.	Emërtimi	Tarifa
1	Tarifa për një shërbim varrim për të rritur	24.000 Lekë
2	Tarifa për një shërbim varrim për të mitur	16.439 Lekë
3.	Tarifa për një shërbim varrimi për të mitur të thjeshtë (deri 60 cm)	12,024 Lekë
4	Zhvarrime kur varri është i parregulluar	14.136 Lekë
5	Zhvarrime kur varri është i rregulluar	31.236 Lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.09.2020




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 899/prot.

TARI
DURRËS

Durrës, më 02.10.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.98 datë 30.09.2020 Për miratimin e një shtese në VKB nr. 468 datë 23.12.2020 “Për sistemin taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit, të ndryshuar”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

Nasto

